



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:247120

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05675360

CP.nr.193/2013

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekom i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit P.B., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 74.29 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 13.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore e kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekom i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit P.B., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 74.29 euro (shtatëdhjetë e katër euro e njëzet e nëntë cent), për shkak se e ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit.

A r s y e t i m

Gjykata me Aktvendimin CP.nr.193/2013 me dt.09.09.2013 e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A.-Vala, tani Telekom i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit P.B., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 124.09 euro, ndërsa me parashtrësën e dt.26.02.2024 e bëri precizimi e borxhit, i cili është në shumën prej 74.29 euro.

Debitori e ka njoftuar gjykatën se e ka përmbushur borxhin në tërësi, kjo dëshmohet përmes dëftesës të lëshuara nga Telekom i Kosovës nr.73739200 e dt.10.05.2024 e cila është në shumën prej 74.29 euro, si dhe taksën gjyqësore në shumën prej 15 euro me nr. të pagesës TT1418109759, e lëshuar nga Raiffeisen Bank me dt.30.06.2014.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 par.4 të LPP-së, në të cilin është përcaktuar se “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret vendim për përfundimin e procedurës përmbartimore”, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
CP.nr.193/2013, me dt.13.05.2024

Gjyqtari
Avdulla Mecinaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.